

Pranuar - Prillogë Më/Dane 16-04-2024 Vllgod			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shënime Prilog	Vlera Vendnost
02-	11/01-		349

## Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosova

Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Viti



Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 08/L-197 neni 5, paragrafi 1.2, nenit 80 dhe 81, Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8, paragrafi 1 dhe 2, si dhe Udhëzimit Administrativ MFPT Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë shpall:

## KONKURS PUBLIK

**Institucioni :** Komuna e Vitisë

**Departamenti/Drejtorja:** Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport

**Titulli i vendit të punës :** Bibliotekist/e në fshatin Sllatinë e Epërme, Komuna Viti.

**Numri i pozitave :** 1 (një)

**Lloji i pozitës :** Nëpunës i Shërbimit Publik

**Grafa/Koeficienti :** E-23 – 4.9

**Orët e punës :** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e kontratës :** Në kohë të pacaktuar,

**Puna provuese :** Gjashtë (6) muaj.

**Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë;**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

**Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës Bibliotekist/e :**

- Bashkëpunon me udhëheqësin e institucionit në krijimin e strategjive dhe projekteve të bibliotekës;
- Formon kartotekën dhe jep informacione përdoruesve ;
- Bën kërkesa dhe jep rekomandime për pasurimin e bibliotekës me tituj të mjaftueshëm;
- Planifikon shfrytëzimin e fondit të librave nga ana e lexuesve - nxënësve;
- Mban raport të rregullt ditor, javor, mujor dhe vjetor lidhur me shërbimet e kryera;
- Siguron arkivimin e mirëmbajtjen e librave;
- Kryen dhe detyra tjera në përputhje me ligjet të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

### **Kualifikimi :**

- Diplomë Universitare : Fakulteti Filologjik – Drejtimet Letërsi Shqipe dhe Gjuhë Shqipe.  
Fakulteti i Edukimit – Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të ketë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Word, Excel, Power Point, Access, Internet).
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

### **Dokumentet e kërkuara për të gjithë kandidatët-aplikantët:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit kopje;
- Dëshmitë e përvojës së punës kopje (nëse ka)
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime (original) pas përzgjedhjes nga komisioni,
- Çertifikata e Mjekut pas përzgjedhjes nga komisioni.

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

### **Afati dhe mënyra e aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 17.04.2024 deri 16.05.2024 .

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në Zyrën e Arhivës të Komunës së Vitisë, kati përdhësë në ndërtesën e administratës së Komunës së Vitisë si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Vitisë, <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkurset-njoftimet/> dhe <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arhivës, Komuna e Vitisë, Rr. “Hasan Kabashi” pa.nr. Viti, Rezultatet shpallën në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkurset-njoftimet/>

Më datë 16.04.2024



Udhëheqësi i NjMBNj

Hysen Ymeri